

INSTITUTI I STUDIMEVE EUROPIANE, UNIVERSITETI I TIRANËS

Master Ekzekutiv 1-vjeçar, viti akademik 2024-2025

"EU Membership and Accession Negotiations"

Kriteret e pranimit:

Për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në "Negociatat dhe Anëtarësimi në Bashkimin Evropian" studentí/ja duhet:

1. Të zotërojë diplomën "Master i shkencave", ose një diplomë tjetër ekuivalente me të (si diplomë e nivelit të dytë, diplomë e integruar e nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër).
2. Të ketë përfunduar studimet e larta në Studime Evropiane, Drejtësi, Ekonomi, Shkenca Sociale, etj., ose të jetë i/e angazhuar profesionalisht në pozicione ku kërkohet ekspertizë në fushën e procesit të integrimit evropian.
3. Të zotërojë gjuhën angleze, duke e vërtetuar me dëshminë përkatëse Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në anglisht, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
4. Të dorëzojë aplikimin dhe dosjen e plotë të dokumentacionit ne sekretari

Dosja e aplikimit

- a) Formulari i aplikimit, që ndodhet edhe në formë elektronike në webin e ISE-së;
- b) Kopjen e noterizuar të diplomës Bachelor dhe diplomën e nivelit Master Shkencor;
- c) Jetëshkrimi i kandidatit (CV);
- d) Letër interesi ku paraqiten arsyet e aplikimit dhe lidhjen e masterit me angazhimin profesional;
- e) Një projekt-ide në lidhje me fushat me interes për kërkim shkencor të aplikantit dhe fushat/kapitujt negociues ku ka interes specifik;
- f) Dy letra rekomandimi nga persona që njohin aftësitë akademike dhe profesionale të kandidatit;
- g) Nëse ka, publikime apo pjesëmarrje në konferenca, që lidhen me fushën;
- h) Dokumentacionin në lidhje me vërtetimin e njohurive të Anglishtes, sipas kriterëve.

protokollohet në sekretarinë e programit të Masterit Ekzekutiv, pranë Institutit të Studimeve Europiane. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve të parashikuara dhe bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës. Shqyrtimi i aplikimeve bëhet nga një Komision i posaçëm dhe kandidatët informohen për rezultatin brenda 1 jave nga mbyllja e afatit të aplikimit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën info@ise.edu

Rruga e Elbasanit, 2, Tiranë, Albania; www.ise.edu.al